



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM
REGULATORNI URED ZA VODU I KANALIZACIJU
WATER AND WASTEWATER REGULATORY OFFICE



ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM ("ZRRUK")
(R-02/U&K)

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM REGULATORNI URED ZA VODU I KANALIZACIJU WATER AND WASTEWATER REGULATORY OFFICE	
Nr. Prot./Prot. Br./Prot. No.	566
Njësia/Jedinica/Unit	22
Nr. Shkres./Zb. Br./Req. No.	
Data/Datum/Date	24.12.2012
PRISHTINË - PRISTINA - PRISHTINA	

RREGULLA

PËR PËRCAKTIM TË TARIFAVE TË SHËRBIMIT

PËR SHËRBIMET E UJËSJELLËSIT, KANALIZIMIT DHE TË

FURNIZIMIT TË UJIT ME SHUMICË NË KOSOVË

24 Dhjetor 2012

PËRMBAJTJA

PJESA I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	3
Kapitulli 1: Dispozitat e Përgjithshme	3
Neni 1: Autoriteti i kësaj Rregulle	3
Neni 2: Fushëveprimi	3
Neni 3: Qëllimi	3
Neni 4: Përkufizimet	3
Neni 5: Rregullat e Interpretimit.....	6
Neni 6: Aplikueshmëria	6
PJESA II: PARIMET E PËRGJITHSHME PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE	6
Kapitulli 2: Politika Tarifore.....	6
Neni 7: Politikat Tarifore - Përgatiten nga Rregullatori	6
Neni 8: Politikat Tarifore – kërkesat minimale.....	7
Kapitulli 3: Shqyrtimi i tarifave.....	8
Neni 9: Shqyrtimet periodike.....	8
Neni 10: Procesi.....	9
Kapitulli 4: Procedurat për përcaktimin e tarifave dhe kërkesat e raportimit	9
Neni 11: Procedurat	9
Neni 12: Kërkesat për Informacion	10
PJESA III: SHQYRTIMI DHE APROVIMI I APLIKACIONEVE TË TARIFAVE TËSHËRBIMIT	10
Kapitulli 5: Aplikimi, Shqyrtimi dhe Aprovimi i Tarifave të Shërbimit.....	10
Neni 13: Aplikacioni për Tarifa Shërbimi.....	10
Neni 14: Shqyrtimi i Aplikacionit për Tarifa Rregullatore Shërbimi	11
Neni 15: Aprovimi i Tarifave të Shërbimit, Korrigjimet e rregullta dhe të Jashtëzakonshme Vjetore	11
Kapitulli 6: Korrigjimet e Jashtëzakonshme të Tarifave të Shërbimit.....	12
Neni 16: Kërkesa për Korrigjime të Jashtëzakonshme të Tarifave të Shërbimit	12
Neni 17: Procedurat e Aprovimit për Korrigjimet e Jashtëzakonshme të Tarifave	12
të Shërbimit.....	12
Neni 18: Refuzimi i Korrigjimit të Jashtëzakonshëm të Tarifave të Shërbimit.....	12
PJESA IV: MARRËVESHJET PËR TARIFA	12
Kapitulli 7: Negocimi dhe Zbatimi i Marrëveshjes për Tarifat e Shërbimit	12
Neni 19: Marrëveshja për Tarifat e Shërbimit	12
Neni 20: Negocimi për Marrëveshjen e Tarifave të Shërbimit	13
Neni 21: Lidhja e Marrëveshjes për Tarifat e Shërbimit	14
Kapitulli 8: Natyra Ligjore dhe Zbatueshmëria e Marrëveshjes së Tarifave të Shërbimit.....	14
Neni 22: Natyra Ligjore dhe Zbatueshmëria e Marrëveshjes së Tarifave të Shërbimit ..	14
Neni 23: Pajtuueshmëria me Marrëveshjen për Tarifat e Shërbimit	14

PJESA V: PUBLIKIMI I TARIFAVE TË SHËRBIMIT	15
Kapitulli 9: Prezantimi dhe Publikimi i Tarifave të Shërbimit	15
Neni 24: Prezantimi i Tarifave të Shërbimit	15
Neni 25: Publikimi dhe Shpërndarja e Listës së Tarifave të Shërbimit	15
PJESA VI: ZBATIMI, GJOBAT DHE ANKESAT	15
Kapitulli 10: Zbatimi i Kushteve të Tarifave të Shërbimit	15
Neni 26: Zbatimi i Kushteve të Tarifave të Shërbimit.....	15
Kapitulli 11: Regjistrat dhe Raportet mbi Kushtet e Tarifave të Shërbimeve.....	16
Neni 27: Vend-ndodhja dhe Disponueshmëria e Regjistrave.....	16
Neni 28: Raportet.....	16
Neni 29: Periudha e Mbajtjes së Regjistrave dhe Raporteve	16
Kapitulli 12: Kundërvajtjet dhe Gjobat	16
Neni 30: Kundërvajtjet dhe Gjobat	16
Kapitulli 13: Ankesat.....	17
Neni 31: Ankesat.....	17
PJESA VII: TË NDRYSHME	17
Neni 32: Gjuha Zyrtare e Rregullës	17
Neni 33: Hyrja në Fuqi	17

PJESA I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Kapitulli 1: Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1: Autoriteti i kësaj Rregulle

Rregullatori e nxjerrë këtë Rregull nën autoritetin e Ligjin Nr. 03/L-086 mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetësimit dhe Kanalizimit të datës 15 qershor 2008.

Neni 2: Fushëveprimi

Të gjithë Ofruesit e Shërbimeve publike të ujit që aktualisht veprojnë në ofrimin e Shërbimeve të Ujësjetësimit dhe Kanalizimit ose Shërbimeve të Furnizimit të Ujit me Shumicë në Kosovë duhet të zbatojnë këtë Rregull dhe procedurat për zhvillim, marrjen e aprovimit dhe ndryshimin e tarifave për shërbime të ofruara.

Neni 3: Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulle është që të krijojë rregulla dhe procedura mbi të cilat mund të përcaktohen dhe zbatohen tarifat për shërbimet e furnizimit me ujë dhe grumbullimin, trajtimin dhe shkarkimin e ujërave të zeza, si dhe për furnizim të ujit me shumicë.

Neni 4: Përkufizimet

Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregullë do kenë kuptimet si në vijim:

Aplikacioni për Tarifat e Shërbimit nënkupton dokumentin e dorëzuar Rregullatorit nga Ofruesit e Shërbimeve, në formatin e përcaktuar nga Rregullatori kohë pas kohe;

Ditë Pune nënkupton cilëndo ditë përveç ditës së Shtunë, Diel apo ditë tjetër që është përcaktuar festë zyrtare në Kosovë;

Faturë nënkupton dokumentin zyrtar të shkruar me të cilin njoftohet marrësi i shërbimit për të paguar për Shërbimet e Ujësjetësimit dhe Kanalizimit, në të cilin përcaktohet shuma e cila duhet të paguhet, periudhën kur janë ofruar shërbimet dhe informatat tjera relevante, e cila i lëshohet Konsumatorit nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujësjetësimit dhe Kanalizimit në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve Nr. 02/L-37;

Furnizimi i Ujit me Shumicë nënkupton ujin e patrajtuar (papërpunuar) me të cilin furnizohet një Ofrues i Shërbimeve të Ujësjetësimit dhe Kanalizimit i cili e (përpunon) trajton ujin dhe ua shpërndanë drejtpërsëdrejti konsumatorëve.

Furnizuesi i Ujit me Shumicë nënkupton cilindo Person që furnizon Ofruesin e Shërbimeve të Ujësjetësimit dhe Ujërave të Zeza me Ujin me Shumicë;

Kërkesa e të Hyrave nënkupton shumën e parave të nevojshme për mbulimin e kostove për ofrimin e Shërbimeve të Ujësjetësimit dhe Ujërave të Zeza ose furnizimit të Ujit me Shumicë të llogaritura në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulle;

Komisioni Shqyrtues nënkupton komisionin që mund të rishikojë vendimet e Rregullatorit në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-086 mbi Ndryshimin e Rregulloren 2004/49 Mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe Mbeturinave ;

Konsumator i Shitjes me Shumicë nënkupton individin dhe/ose personin ose subjektin ligjor i cili blen Ujin me Shumicë nga Ofruesi i Shërbimeve për qëllime të ri-shitjes së tij palës së tretë;

Konsumator nënkupton Personin i cili ka lidhur Kontratë për Shërbimet e Ujësjellësit dhe Ujërave të Zeza ose për Furnizim të Ujit me Shumicë me Ofruesin e Shërbimeve ose i cili ka marrë në mënyrë ligjore Shërbime të Ujësjellësit që ofrohen nga Ofruesi i Shërbimeve;

Kategoria e Konsumatorëve nënkupton kategorinë e konsumatorëve të definuar si në vijim

- i. **Konsumatori Institucional** nënkupton cilindo subjekt ligjor të klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si autoritet qeveritar, autoritet lokal, organizatë ndërkombëtare ose institucion i cili kryen aktivitetet me interes të përbashkët ose publik dhe që nuk është i regjistruar si organizatë afariste, në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare Nr.02/L123;
- ii. **Konsumatori Komercial/Industrial** nënkupton cilindo person, subjekt ligjor ose organizatë afariste të klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si Konsumator që shfrytëzon Shërbimet për ose në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë komerciale apo industriale të çfarëdo lloji;
- iii. **Konsumatori Shtëpiak** nënkupton cilindo Konsumator të klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si person që shfrytëzon Shërbimet në objektin e banimit ose amvisërinë e tij apo saj;

Kontrata e Shërbimit nënkupton një marrëveshje me shkrim në mes të Ofruesit të Shërbimeve dhe Konsumatorëve, nëse nuk ekziston marrëveshje e tillë, atëherë vlejnë kushtet e shërbimeve të ofruara nga Ofruesi i Shërbimeve;

Kostot Operative nënkupton kostot racionale dhe të nevojshme që lidhen me funksionimin dhe mirëmbajtjen e impianteve të trajtimit të ujit dhe ujërave të zeza, rezervuarve, puseve, pompave, linjave transmetuese dhe atyre shpërndarëse, objekteve tjera të ujësjellësit dhe ujërave të zeza, dhe shpenzimet për shërbimet e konsumatorëve si dhe ato të administratës së përgjithshme;

Kthimi në Kapital nënkupton një kthim adekuat në vlerën rregullatore të kapitalit të paraqitur si të hyra vjetore e shprehur në përqindje e cila i shtohet investimit origjinal me të cilën rritet vlera e kapitalit të investuar;

Lista e Tarifave të Shërbimit nënkupton të gjitha Tarifat e zbatueshme të Shërbimit për Zonën e Shërbimit sipas llojit të shërbimit, lokacionit dhe kategorisë së Konsumatorëve dhe tarifat për Shërbimet e Ujësjellësit dhe Kanalizimit që janë aprovuar nga Rregullatori;

Ofruesi i Shërbimeve nënkupton cilindo Ofrues të Shërbimeve të Ujësjellësit dhe Ujërave të Zeza apo Furnizuesit të Ujit me Shumicë, së bashku të përfshirë si “Ofruesit e Shërbimeve”;

Personi nënkupton individin, subjektin ligjor ose publik përfshirë korporatën, ortakërinë, trustin, organizatë të painkorporuar, qeveri apo agjencion apo cilëndo nën-ndarje të tyre;

Politika Tarifore nënkupton politikën e rregullatorit e cila vendos parimet mbi të cilat përcaktohen tarifat e shërbimit;

Rregullatori nënkupton autoritetin i cili është përgjegjës për rregullimin ekonomik të Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetës dhe Kanalizimit. Gjithashtu referohet si “Zyra Rregullore për Ujësjetës dhe Kanalizim (“ZRRUK”) e themeluar me Rregulloren 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetës, Kanalizimit dhe Mbeturinave të datës 26 nëntor 2004 të amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-086 të datës 15 qershor 2008;

Shërbimet e Kanalizimit nënkupton grumbullimin, deponimin, trajtimin dhe shkarkimin e ujërave të zeza dhe operimin e rrjetit ose stabilimenteve për qëllimet e tilla.

Shërbimet e Ujësjetës nënkupton marrjen, trajtimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum njerëzor dhe operimin e rrjetit dhe stabilimenteve për qëllimet e tilla;

Shpenzimet Kapitale nënkupton shpenzimet që shkaktohen lidhur me investimet në asetet fikse me jetëgjatësi më shumë se një vit përfshirë pa kufizim shpenzimet që janë llogaritur të amortizohen dhe zhvlerësohen gjatë jetëgjatësisë së cilatdo aseti fiks të dhënë, të klasifikuar si pronë, stabiliment ose pajisje;

Struktura e Tarifore nënkupton elementet specifike të tarifave të shërbimit përfshirë blloktarifat, komponentët fiks të tarifave, taksat e kyçjës dhe hollësitë tjera lidhur me aplikimin e tarifave të shërbimit që janë aprovuar nga Rregullatori;

Taksa e Kyçjës (dhe Ri-kyçjës) nënkupton taksat e Ofruesit të Shërbimeve për sigurimin e kyçjeve të reja (ose rikyçjet) në shërbimet e furnizimit me ujë ose shërbimet e kanalizimit siç janë të aprovuara nga Rregullatori;

Tarifa e Shërbimit nënkupton cilatdo vlera, ngarkesa apo taksa të Ofruesit të Shërbimeve lidhur me Ofrimin e Shërbimeve të tyre Konsumatorëve;

Uji me Shumicë nënkupton ujin që nuk është trajtuar/ose i trajtuar në mënyrë që të jetë i përshtatshëm për konsum njerëzor;

Urdhëresa e Tarifave të Shërbimit nënkupton dokumentin me shkrim, të lëshuar nga Rregullatori ku janë të përfshira të gjitha Tarifat e Shërbimit për Zonat e Shërbimit sipas llojit, lokacionit dhe kategorisë së Konsumatorëve dhe tarifat për Shërbimet e Ujësjetës dhe Kanalizimit të ofruara Konsumatorëve;

Zhvlerësimi nënkupton masën e harxhimit (konsumit), shfrytëzimit ose amortizimit të aseteve gjatë periudhës së jetëgjatësisë së tyre ekonomike;

Zona e Shërbimit nënkupton zonën e përcaktuar në Licencën e Shërbimit të Ofruesve të Shërbimeve në të cilën ata janë të obliguar të ofrojnë shërbime të furnizimit me ujë dhe shërbimet e ujërave të zeza.

Neni 5: Rregullat e Interpretimit

Në këtë Rregull:

- a) Cilat do fjalë dhe shprehje të përdorura në këtë Rregull të cilat nuk janë definuar në mënyrë specifike dhe janë të paqarta do të kenë kuptimin siç është përcaktuar në aktet ligjore, të përmendura në Hyrjen e kësaj Rregulle dhe/ose në cilindo ligj tjetër të zbatueshëm në Kosovë;
- b) Referencat në këtë Rregull duhet të interpretohen sipas kuptimit të cilësdo Rregull të lëshuar, modifikuar, ndryshuar, plotësuar dhe/ose zëvendësuar nga Rregullatori kohë pas kohe në pajtim me fuqitë e dhëna Rregullatorit;
- c) Njëjësi përfshinë shumësin dhe anasjelltas;
- d) Fjalët që përdorin njërën gjini do të përfshijnë gjininë tjetër; dhe
- e) Referencat për Pjesët, Kapitujt dhe Nenet përveç nëse shprehimisht nuk është thënë ndryshe janë referenca për Pjesë, Kapituj dhe Nenet e këtyre Rregullave.

Neni 6: Aplikueshmëria

Nga të gjithë Ofruesit e Shërbimeve Publike të Ujit në Kosovë që aktualisht ofrojnë Shërbime të Ujësjetësimit dhe Kanalizimit ose Furnizim të Ujit me Shumicë kërkohet ti dorëzojnë Rregullatorit për aprovim tarifave të ujësjetësimit dhe ujërave të zeza dhe të furnizimit të ujit me shumicë për përdorimet e ndryshme sipas strukturës së tyre tarifore të llogaritur në pajtim me këtë Rregull përveç nëse nuk bëhet ndonjë përjashtim i veçantë dhe i dhënë me shkrim nga Rregullatori.

PJESA II: PARIMET E PËRGJITHSHME PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE

Kapitulli 2: Politika Tarifore

Neni 7: Politikat Tarifore - Përgatiten nga Rregullatori

7.1. Rregullatori duhet të përpilojë politikat tarifore për Shërbimet e Ujësjetësimit dhe Kanalizimit dhe Furnizim të Ujit me Shumicë duke marrë parasysh:

- a) Të gjitha obligimet ligjore që kanë të bëjnë me përcaktimin e tarifave të shërbimit
- b) Përgjegjësinë sociale dhe rolin e ofruesve të shërbimeve:
 - i. Uniformiteti i tarifave në zonat e shërbimit kur është nevoja
 - ii. Kategoritë e ndryshme të konsumatorëve, pengesat e tyre në mundësinë për të paguar dhe kostot e tyre përkatëse të shërbimit
 - iii. Strukturat e tarifave përfshirë nevojën për bllok tarifave dhe tarifave fikse
 - iv. Nivelet e shërbimit
- c) Taksat e kyçjeve/ri-kyçjeve dhe përshtatshmërinë e kontributeve ndaj investimeve kapitale
- d) Mjedisin:

- i. Përshtatshmërinë e strukturës tarifore për menaxhimin e kërkesës dhe taksat për marrjen e ujit të papërpunuar
 - ii. Caqet për reduktimin e humbjeve të ujit
 - iii. Detyrimi mjedisor për kujdesin dhe pajtueshmërinë me standardet e mjedisit
- e) Mbulimin e kostos:
- i. Përkufizimi
 - ii. Kostot operative dhe pritjet e eficiencës
 - iii. Mbulimi i shpenzimeve të investimeve kapitale
- f) Financimin, strukturën e kapitalit dhe kthimin në kapital
- g) Procesin e shqyrtimit të tarifave
- h) Çfarëdo qëndrimi tjetër të politikës tarifore siç përcaktohet nga Rregullatori.

7.2. Politikat tarifore duhet të përpilohen përmes procesit të konsultimit me palët e interesit.

7.3. Rregullatori duhet të publikojë Politikat Tarifore që do të jenë në dispozicion për publikun.

7.4. Rregullatori duhet të rishikojë Politikat Tarifore në mënyrë periodike dhe kur është nevoja ato duhet të ndryshohen në rast të:

- a) Ndryshimeve në politikën qeveritare
- b) Amendamenteve në legjislacionin ekzistues dhe/ose të ri që kërkon ndryshimin në Politikat Tarifore
- c) Amendamenteve në këto rregulla, ose
- d) Dështimit që Politikat ekzistuese Tarifore të japin rezultate të pritura dhe/ose identifikimit të pozitës alternative që mund të jep rezultate më të mira.

Neni 8: Politikat Tarifore – kërkesat minimale

8.1. Tarifat e Shërbimit për furnizim të ujit dhe shërbimet e ujërave të zeza dhe të furnizimit të ujit me shumicë nuk duhet të jenë diskriminuese dhe, përveç nëse ndryshe vendoset nga Rregullatori, Ofruesit e Shërbimeve duhet të përdorin Tarifat e njëjta të Shërbimit në Zonat e tyre të Shërbimit

8.2. Rregullatori mund të përcaktojë tarifa zonale brenda regjionit të caktuar të shërbimit, për ato grupime të konsumatorëve që u ofrohen shërbime të ujit dhe shërbime të trajtimit të ujërave të zeza, ose furnizimit të ujit me shumicë të trajtuar ose të pa trajtuar pa i ndikuar tarifatat ekzistuese të pjesës tjetër të regjionit përkatës.

8.3. Tarifat për shërbimet e furnizimit të ujit me shumicë duhet të përcaktohen në bazë të kostove aktuale të furnizimit tek secili Ofrues i Shërbimeve të Ujës-jellësit dhe Kanalizimit.

8.4. Tarifat duhet të përcaktohen në bazë të asaj që rrjedhja e të hyrave që ato i gjënerojnë, të jenë të mjaftueshme për të financuar aktivitetet e Ofruesve të Shërbimeve në përputhshmëri me kërkesat e tyre ligjore dhe Rregullatore që mund të përfshijë kthimin e arsyeshëm në kapital në të cilin ata kanë investuar.

8.5. Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë autorizim nga Rregullatori për përdorim të tarifave të ndryshme të Shërbimit brenda zonave të caktuara të shërbimeve të tij, duke arsyetuar kërkesën e tillë dhe Rregullatori duhet të përgjigjet me shkrim brenda njëzet (20) ditëve të punës nga data e pranimit të kërkesës së tillë, duke pranuar ose refuzuar ta bëjë këtë si dhe të sigurojë arsyet për qëndrimin e tij.

8.6. Tarifat e Shërbimit për Shërbimet e Ujësjetës dhe Kanalizimit duhet të përfshijnë jo më shumë se tri kategori të Konsumatorëve:

- a) Shtëpiak;
- b) Komercial/Industrial;
- c) Institucional;

8.7. Konsumator i Shitjes me Shumicë do të jetë e vetmja Kategori e Konsumatorëve për Furnizim të Ujit me Shumicë.

Kapitulli 3: Shqyrtimi i tarifave

Neni 9: Shqyrtimet periodike

9.1. Tarifat për shërbimet e ujësjetës, kanalizimit dhe shërbimeve të furnizimit të ujit me shumicë duhet të përcaktohen për një periudhë jo më pak se tri vite dhe jo më shumë se pesë vite.

9.2. ZRRUK ka të drejtë për rishikim – korrigjim të tarifave të përcaktuara të vitit pasues gjatë periudhës së ekzistimit të tarifave tri (3)/ose pesë (5) vjeçare, për mos përmbushje të caqeve të përcaktuar me procesin rregullatorë, posaçërisht në rastet kur dështohet në realizmin e projekteve të investimev kapitale të aprovuara me burim vetanak financimi të cilat janë kalkuluar si kosto për tarifë.

- a) Inicimi i rishikimeve të tilla tarifore bëhet nga ZRRUK, pas analizës 9 mujore/ ose pas përmbylljes së vitit fiskal ekzistues, për të përcaktuar tarifat e vitit pasues, në rastet kur ZRRUK sigurohet se nuk mund të arrihen/ose ofrohen për tu arrit caqet e përcaktuara me procesin rregullator. Këto veprime do të ndërmerren pas një analize dhe vlerësimi të gjithanshëm të rrethanave të mjedisit biznesor.
- b) UTSH-ët për rastin e pikës 9.2. do të lëshohen para përmbylljes së vitit të shikuar, ose ma së voni nga 25 – gjer me 31 janar të vitit në të cilin hynë.

9.3. Tarifat për furnizim të ujit me shumicë do të përcaktohen për periudhat e ngjashme si për shërbimet e ujësjetës dhe kanalizimeve.

9.4. Tarifat për secilin vit brenda periudhës së shqyrtimit duhet të përcaktohen paraprakisht në bazë të kostove reale duke përjashtuar efektet e inflacionit.

9.5. Tarifat aktuale që do të aplikohen duhet të jenë të përcaktuara gjatë shqyrtimit shumëvjeçar të përshtatur (korrigjuar) për lëvizjet e përgjithshme inflatore të çmimeve me pakicë që ka ndodhur në vitin para procesit të korrigjimit, dhe për arritje/ose mos arritje të caqeve të përcaktuar me procesin tariforë të vitit të shikuar.

Neni 10: Procesi

Para fillimit të vitit përfundimtar të secilës periudhë të shqyrtimit, Rregullatori do të përcaktojë orarin e aktiviteteve të nevojshme për të ndërmarrë shqyrtimin e tarifave për periudhën vijuese. Këto aktivitete duhet të përfshijnë (por jo të kufizohen në):

- a) Qasjen e Rregullatorit për përcaktimin e tarifave (draft Procedurat) në shqyrtimin e ardhshëm si dokument konsultues
- b) Mundësinë për përfshirjen e palëve të interesit (Ofruesit e Shërbimeve, konsumatorët dhe palët tjera të interesit) dhe publikimin e Procedurave finale
- c) Kërkesat e hollësishme për informacione të cilat janë të nevojshme për përmbushjen e kërkesave të përcaktuara me Procedura
- d) Draftin e tarifave të përcaktuara e të bazuara në Procedura
- e) Mundësinë e përfshirjes së komenteve nga palët e interesit në draftin e tarifave të përcaktuara
- f) Publikimin e tarifave finale të përcaktuara që do të aplikohen në periudhën shqyrtuese.

Kapitulli 4: Procedurat për përcaktimin e tarifave dhe kërkesat e raportimit

Neni 11: Procedurat

11.1. Rregullatori duhet të përgatis, para secilit Shqyrtim periodik të Tarifave, një pako të Procedurave për Tarifat e Furnizimit me Ujë dhe shërbime të kanalizimeve që:

- a) Ofrjnë koncepte të përgjithshme të procesit për përcaktimin e tarifave për periudhën e ardhshme të shqyrtimit
- b) Përshkruajnë modelin financiar që do të përdoret në proces
- c) Përshkruajnë në detaje komponentët individuale të modelit për përcaktimin e tarifave duke përfshirë:
 - i. Parashikimet e shitjeve të llogaritura;
 - ii. Kostot operative;
 - iii. Mirëmbajtjen e kapitalit;
 - iv. Kthimin në kapital (përfshirë definimin e vlerës rregullatore të kapitalit);
 - v. Procesin e llogaritjes së tarifave;
 - vi. Procesin e përshtatjes ('smoothing') kur është nevoja;
 - vii. Rregullat e indeksimit për korrigjimet e ndërmjetme;
 - viii. Hollësitë tjera siç përcaktohen nga Rregullatori.

11.2. Rregullatori do të përgatis procedura për rishikim periodik të tarifave të shërbimeve të ujit për rastet kur rishqyrton tarifat për mos arritje të caqeve të përcaktuara me procesin e rregullt 3 ose 5 vjeçar tariforë dhe posaçërisht për mos realizim të projekteve të aprovuara nga KRU-të për investimeve kapitale me të cilat ngritët baza rregullatore e kapitalit dhe niveli i shërbimeve me financim vetanak të cilat e kanë ngarkuar tarifat,

11.3. Tarifat duhet të përcaktohen në pajtim me Procedurat e finalizuara.

Neni 12: Kërkesat për Informacion

12.1. Rregullatori duhet të përcaktojë Kërkesat për Informacion të nevojshme për përcaktim të tarifave në pajtim me Procedurat.

12.2. Ofruesi i Shërbimeve duhet të sigurojë informacione të nevojshme në pajtim me Kërkesat për Informacion dhe brenda afatit të përcaktuar nga Rregullatori.

12.3. Këto Kërkesa për Informacion kanë të bëjnë me:

- a) Parashikimet e performancës (prodhimi, shitjet, kyçjet, tarifatat fikse etj.)
- b) Parashikimet e kostove operative;
- c) Shpenzimet kapitale përfshirë mirëmbajtjen kapitale;
- d) Amortizimin sipas nevojës;
- e) Detajet e financimit;
- f) Informacionet tjera të përcaktuara nga Rregullatori si të nevojshme për përcaktimin e tarifave.

12.4. Rregullatori nuk është i obliguar të marrë parasysh informacionet e dhëna nga Ofruesit e Shërbimeve dhe nëse Rregullatori konsideron që parashikimet e performancës, kostot, investimet dhe burimet e financimit nuk janë reale atëherë Rregullatori mund:

- a) T'i kthejë të dhënat Ofruesit të Shërbimeve për rishqyrtim dhe korrigjim; ose
- b) Të përdorë të dhëna alternative të cilat sipas mendimit të Rregullatorit më mirë reflektojnë performancën e pritur të ardhshme të Ofruesit e Shërbimeve.

PJESA III: SHQYRTIMI DHE APROVIMI I APLIKACIONEVE TË TARIFAVE TË SHËRBIMIT

Kapitulli 5: Aplikimi, Shqyrtimi dhe Aprovimi i Tarifave të Shërbimit

Neni 13: Aplikacioni për Tarifa Shërbimi

13.1. Ofruesi i Shërbimeve duhet të dorëzojë Aplikacionin për Tarifa të Shërbimit në pajtim me Procedurat së bashku me të gjitha informacionet mbështetëse siç është përcaktuar në Kërkesat për Informacion.

13.2. Ofruesi i Shërbimeve duhet të sigurojë informacione shtesë për të mbështetur Aplikacionin e Tarifave të Shërbimit siç kërkohet nga Rregullatori.

13.3. Aplikacioni i Tarifave të Shërbimit duhet të aprovohet nga Bordi i Drejtorëve i Ofruesve të Shërbimeve që dëshmohet me letrën përcjellëse të nënshkruar nga autoriteti relevant.

13.4. Rregullatori mban të drejtën për të përcaktuar tarifatat në pajtim me Procedurat dhe informacionet e siguruarat në pajtim me Kërkesat për Informacione, në rast se Ofruesi i Shërbimeve nuk e dorëzon Aplikacionin formal të Tarifave.

13.5. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i dorëzon informacionet e nevojshme mbështetëse në pajtim me Kërkesat për Informacion dhe në afat të përcaktuar në Procedura, Rregullatori do të përcaktojë Tarifën e Shërbimit bazuar në supozimet e Rregullatorit për kërkesën e të hyrave dhe nivelin e pritshëm të efikasitetit të Ofruesit të Shërbimeve dhe performancës operative. Në rastet e tilla, Tarifën e Shërbimit do të jetë jo më të larta, në kuptimin real (pas përshtatjes për inflacion) se tarifa e aplikuar në fund të periudhës së mëparshme periodike të shqyrtimit.

Neni 14: Shqyrtimi i Aplikacionit për Tarifa Rregulatore Shërbimi

14.1. Rregullatori duhet të konfirmojë që Aplikacioni i Tarifave të Shërbimit është në përputhshmëri me kushtet e kësaj Rregulle, Procedurat dhe Kërkesat për Informacion. Rregullatori duhet të shqyrtojë me hollësi dhe të vlerësojë Aplikacionin për Tarifa Shërbimi, qoftë për ta aprovuar ose refuzuar aplikacionin.

14.2. Rregullatori duhet të vlerësojë Aplikacionin për Tarifën e Shërbimit në bazë të:

- a) Përputhshmërisë së tij me Procedurat, Kërkesat për Informacion dhe kërkesat tjera rregulatore;
- b) Parashikimeve të performancës teknike dhe financiare në të cilat është bazuar Aplikacioni për Tarifa Shërbimi të cilat duhet të përmbushin pritjet e Rregullatorit të caqeve reale dhe të arritshme të performancës;
- c) Kostove operative të cilat duhet të reflektojnë përmirësimet sfiduese por reale të efikasitetit siç është përcaktuar nga Rregullatori;
- d) Parashikimeve të shpenzimeve të Investimeve Kapitale të cilat duhet të jenë reale dhe mund të arsyetohen, nëse është nevoja, në përmbushjen e standardeve të shërbimit dhe/ose niveleve të shërbimit;

14.3. Gjatë vlerësimit të Aplikacionit për Tarifa Shërbimi, Rregullatori duhet të marrë parasysh performancën ekonomike dhe financiare të Ofruesit të Shërbimeve duke krahasuar atë me performancën e krahasueshme e të pritur ose aktuale të Ofruesve tjerë të Shërbimeve duke pasur me këtë rast parasysh faktorët jo tipik përfshirë pengesat topografike, ekonominë e shkallës dhe të ngjashme.

Neni 15: Aprovimi i Tarifave të Shërbimit, Korrigjimet e rregullta dhe të Jashtëzakonshme Vjetore

15.1. Në bazë të kriterëve të vlerësimit të përcaktuar në këtë Nen, Rregullatori duhet të aprovojë me apo pa modifikime Aplikacionin për Tarifa të Shërbimit me shkrim pas lëshimit të Urdhërësës për Tarifa.

15.2. Tarifën e Aprovuar të Shërbimit do të aplikohen për Periudhën e Shqyrtimit të Tarifave, të cilat i nënshtrohen korrigjimeve vjetore në pajtim me rezultatet e shqyrtimit të gjithanshëm të tarifave për lëvizjet inflatore siç është përcaktuar në Procedura dhe për mos arritje të caqeve të përcaktuara për realizim me procesin tariforë të periudhës e posaçërisht atyre të investimeve kapitale të periudhës së shikuar.

15.3. Në të kundërtën, gjatë periudhës ndërmjet dy Shqyrtimeve të proceseve tarifore, Tarifën e Shërbimit duhet të mbesin të pandryshuar për secilin vit.

Kapitulli 6: Korrigjimet e Jashtëzakonshme të Tarifave të Shërbimit

Neni 16: Kërkesa për Korrigjime të Jashtëzakonshme të Tarifave të Shërbimit

16.1. Ofruesi i Shërbimeve do të këtë të drejtë të dorëzojë aplikacionin për Korrigjime të Jashtëzakonshëm të Tarifave të Shërbimit në pajtim me Procedurat.

16.2. Aty ku Procedurat nuk specifikojnë kushtet e Korrigjimeve të Jashtëzakonshme të Tarifave të Shërbimit mund të aplikohen ose Procedurat nuk parashikojnë rrethanat që nuk kanë qenë të mundshme për tu parashikuar në përgatitjen e Aplikacionit të Tarifave të Shërbimit, Ofruesi i Shërbimeve ka të drejtë të dorëzojë, në çfarëdo kohe, Rregullatorit kërkesën me shkrim me të gjitha informatat e nevojshme mbështetëse për korrigjim të Tarifave të Shërbimeve më të larta ose më të ulëta se sa ato të aprovuara ose përcaktuara nga Rregullatori.

16.3. Korrigjimet e Jashtëzakonshme të Tarifave të Shërbimit, kur është nevoja duhet të bëhen vetëm në fillim të secilit vit brenda periudhës së shqyrtimit të tarifave përveç nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i shpreh Rregullatorit nevojën për korrigjimin e Tarifës së Shërbimit brenda vitit.

Neni 17: Procedurat e Aprovimit për Korrigjimet e Jashtëzakonshme të Tarifave të Shërbimit

17.1. Rregullatori duhet të konfirmojë që Kërkesa për Korrigjime të Jashtëzakonshme të Tarifave të Shërbimit është në përputhje me Rregullën mbi Tarifat e Shërbimit dhe të vlerësojë dhe të përgjigjet brenda dyzet e pesë (45) Ditëve të Punës nga data e pranimit të aplikacionit të tillë nga Rregullatori.

17.2. Rregullatori duhet të vlerësojë Kërkesën për Korrigjim të Jashtëzakonshme të Tarifave të Shërbimit në pajtim me Procedurat ose në pajtim me rrethanat e përshkruara në aplikacionin që janë të mjaftueshme të sigurojnë Korrigjimin e Jashtëzakonshëm të Tarifave të Shërbimit.

17.3. Nëse Rregullatori është i kënaqur me kërkesën për Korrigjim të Jashtëzakonshëm të Tarifave të Shërbimit e cila përmbush kërkesat për korrigjim, Rregullatori do të aprovojë me shkrim Kërkesën pas lëshimit të Urdhërësës të Tarifave të Shërbimit.

Neni 18: Refuzimi i Korrigjimit të Jashtëzakonshëm të Tarifave të Shërbimit

Rregullatori mund të refuzojë të aprovojë kërkesën për korrigjim të Jashtëzakonshëm të Tarifave të Shërbimit bazuar në:

- a) dështimin e Aplikuesit të sigurojë informacionet e kërkuara brenda afatit të caktuar;
- b) vlerësimin se kërkesa e Aplikuesit nuk është financiarisht e arsyeshme;
- c) vlerësimin se Aplikuesi nuk ka përmbush standardet minimale të shërbimit,
- d) dështimin e Aplikuesit të kontrollojë kostot operative ose humbjet e ujit ose të dajat.

PJESA IV: MARRËVESHJET PËR TARIFA

Kapitulli 7: Negocimi dhe Zbatimi i Marrëveshjes për Tarifat e Shërbimit

Neni 19: Marrëveshja për Tarifat e Shërbimit

19.1. Rregullatori mund të lidh marrëveshje me shkrim me cilindo Ofrues të Shërbimeve me qëllim ndryshimi, zëvendësimi ose plotësimi të Tarifave të Shërbimit të përcaktuara sipas kësaj Rregulle.

19.2. Marrëveshjet për Tarifat e Shërbimit mund të lidhen duke dhënë paraprakisht ndonjë kusht të përcaktuar nga Rregullatori i cili i propozohet Ofruesit të Shërbimeve duke përfshirë, pa kufizime, lidhjen e marrëveshjeve tjera me Ofruesin e Shërbimeve mbi:

- a) Nxjerrjen, përtëritjen, zgjerimin, ndryshimin, dhe plotësimin e Standardëve të Shërbimit;
- b) Lëshimin, përtëritjen, vazhdimin, ndryshimin, dhe plotësimin e Licencës së Shërbimit;
- c) Zgjerimin apo zvogëlimin e fushëveprimit territorial të Zonës së Shërbimit;
- d) Zgjerimin, rehabilitimin ose riparimin e Rrjeteve të Ujësjetës;
- e) Krijimin, zëvendësimin, zgjerimin, modifikimin dhe/ose plotësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me konsumatorë, siç është përcaktuar në Rregullën mbi Kartën e Konsumatorëve të lëshuar, ndryshuar, modifikuar dhe/ose plotësuar nga Rregullatori kohë pas kohe.

19.3. Për mënjanimin e dyshimit, Ofruesit e Shërbimeve kanë të drejtë por jo obligim ti propozojnë Rregullatorit të lidhin Marrëveshjen për Tarifat e Shërbimit, në pajtim me dispozitat e Nenit 20.

Neni 20: Negocimi për Marrëveshjen e Tarifave të Shërbimit

20.1. Ofruesit e Shërbimeve të cilët dëshirojnë të lidhin Marrëveshje për Tarifat e Shërbimit duhet të parashtrijnë kërkesë me shkrim Rregullatorit, duke kërkuar hapjen e negociatave për të lidhur marrëveshjen e tillë dhe arsyetuar pse ata konsiderojnë se interesat publike, e drejta e tyre ligjore dhe pritjet e tyre ligjore do të përmbushen më mirë nëse Rregullatori pranon të lidh Marrëveshje për Tarifat e Shërbimit.

20.2. Rregullatori duhet të përgjigjet me shkrim brenda pesë (5) Ditëve të Punës nga data e pranimit të kërkesës së tillë, duke u pajtuar me hyrjen në negociata për lidhjen e Marrëveshjes për Tarifa të Shërbimit ose duke e refuzuar atë.

20.3. Nëse Rregullatori refuzon të fillojë negociatat për lidhjen e Marrëveshjes për Tarifat e Shërbimit, ai duhet të tregojë arsyet e refuzimit të tillë.

20.4. Nëse Rregullatori pranon të fillojë negociata për të lidh Marrëveshje për Tarifat e Shërbimit, ai duhet t'i ofrojë Ofruesit të Shërbimeve një periudhë të arsyeshme kohore në cilindo rast, por jo më pak se tridhjetë (30) Ditë të Punës për të mundësuar Ofruesit të Shërbimeve të dorëzojë Rregullatorit propozimin e Marrëveshjes për Tarifat e Shërbimit.

20.5. Brenda dhjetë (10) Ditëve të Punës të pranimit të draft Marrëveshjes për Tarifat e Shërbimit, Rregullatori duhet të njoftoj me shkrim Ofruesin e Shërbimeve për caktimin e takimit të parë për të negociuar për atë marrëveshje.

20.6. Rregullatori mund të përcaktojë periudhën maksimale kohore për konkludimin e negociatave për të lidhur Marrëveshjen për Tarifat e Shërbimit, e cila nuk mund të jetë më pak se njëzet (20) Ditë të Punës nga data e caktimit të takimit të parë të negociatave si në pikën 20.5.

20.7. Për mënjanimin e dyshimit, Rregullatori ka të drejtë por jo edhe obligim të lidhë Marrëveshje për Tarifa të Shërbimit, prandaj as refuzimi i tij për të hyrë në negociata për të lidh atë marrëveshje ose çfarëdo dështimi për të kompletuar me sukses negociatat konsiderohen si vendime kontraktuese dhe

jo si akte administrative apo vendimet që i nënshtrohen ndonjë shqyrtimi administrativ ose gjyqësor.

Neni 21: Lidhja e Marrëveshjes për Tarifat e Shërbimit

21.1 Në rast të konkludimit të suksesshëm nga negociatat e bëra në pajtim me Nenin 38 të Ligjit me Nr: 03/L-086, Rregullatori dhe Ofruesi i Shërbimeve duhet të lidhin me shkrim Marrëveshjen për Tarifat e Shërbimit.

21.2. Marrëveshja për Tarifat e Shërbimit duhet të nënshkruhen në tri versione të gjuhëve që përdoren në Kosovë:

- a) Gjuhën shqipe;
- b) Gjuhën serbe; dhe
- c) Gjuhën angleze.

21.3. Në rast të mospërputhshmërisë së versioneve në të cilat nënshkruhet Marrëveshja për Tarifat e Shërbimit, versioni në Gjuhën Shqipe do të mbizotërojë.

21.4. Përveç nëse ndonjë fakt, informacion dhe/ose dokument mund të konsiderohen se përmbajnë ndonjë informacion të privilegjuar ose konfidencial, që Rregullatori mund të arsyetojë me vendim me shkrim, Marrëveshja për Tarifat e Shërbimit, Shtojcat e saj dhe të gjitha informacionet e përdorura për negociata dhe lidhjen e marrëveshjes së tillë do të jetë në dispozicion për publikun me anë të mjeteve të cilat Rregullatori mund t'i përcaktojë kohë pas kohe.

21.5. Çdo ndryshim, zëvendësim, modifikim ose plotësim i dispozitave që lidhen me Marrëveshjen për Tarifat e Shërbimit do të kërkojë pëlqimin nga Rregullatori dhe Ofruesi i Shërbimeve që ka nënshkruar atë dhe duhet të bëhet me shkrim dhe të publikohet sipas dispozitave të nenit 25.1.

Kapitulli 8: Natyra Ligjore dhe Zbatueshmëria e Marrëveshjes së Tarifave të Shërbimit

Neni 22: Natyra Ligjore dhe Zbatueshmëria e Marrëveshjes së Tarifave të Shërbimit

22.1. Marrëveshja për Tarifa të Shërbimit konsiderohet si kontratë administrative për të gjitha qëllimet e synuara ligjore ku Rregullatori është i obliguar të negociojë, lidh dhe zbatojë marrëveshjen e tillë me një observim strikt të parimeve të përgjithshme ligjore, rregullave dhe procedurave që drejtojnë detyrën e të drejtave dhe funksioneve të autoritetit publik.

22.2. Marrëveshja për Tarifat e Shërbimit, si akt bilateral ligjor lidhet në mënyrë të ligjshme, zbatohet dhe ekzekutohet në pajtim me kushtet e të dyja palëve dhe mund të ndryshohet, zgjerohet, modifikohet, plotësohet, shqyrtohet ose ndërprehet vetëm në pajtim me dispozitat e saja dhe ligjin e zbatueshëm në Kosovë.

Neni 23: Pajtueshmëria me Marrëveshjen për Tarifat e Shërbimit

Ofruesit e Shërbimeve janë të obliguar të respektojnë dhe të jenë në përputhshmëri me Tarifat e Shërbimit të përcaktuara me kushtet e përgjithshme të kësaj Rregulle:

- a) Përderisa negociatat për lidhjen e Marrëveshjes së Tarifave të Shërbimit janë në pritje, deri në datën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes së tillë;
- b) Menjëherë me përfundimin, anulimin, revokimin ose skadimin e Marrëveshjes së Tarifave të Shërbimit përveç nëse nuk është arritur ndonjë marrëveshje që të mbetet në fuqi çfarëdo të drejta dhe obligime të cilat i përmban Marrëveshja për Tarifat e Shërbimit kur kjo shfuqizohet për çfarëdo shkaqe ligjore;
- c) Në të gjitha aspektet ku Marrëveshja për Tarifat e Shërbimit nuk ka përcaktuar ndryshe ose në të gjitha aspektet të cilat nuk i ka paraparë në mënyrë specifike ajo marrëveshje;

PJESA V: PUBLIKIMI I TARIFAVE TË SHËRBIMIT

Kapitulli 9: Prezantimi dhe Publikimi i Tarifave të Shërbimit

Neni 24: Prezantimi i Tarifave të Shërbimit

Ofruesi i shërbimeve duhet të përmbledh Tarifat e Shërbimit ashtu siç janë aprovuar, korrigjuar dhe/ose rishikuar nga Rregullatori në Listës së Tarifave të Shërbimit që do të përgatitet siç është përcaktuar nga Rregullatori kohë pas kohe.

Neni 25: Publikimi dhe Shpërndarja e Listës së Tarifave të Shërbimit

25.1. Ofruesi i Shërbimeve duhet t'ia shpërndajë secilit Konsumator Listën e Tarifave të Shërbimit siç është aprovuar nga Rregullatori, në kohën kur Konsumatori ka kompletuar Kontratën e Shërbimit ose njëherë në vit të bashkëngjis të njëjtën Faturës.

25.2. Tarifat e Shërbimit siç janë aprovuar nga Rregullatori duhet të publikohen nga Ofruesi i Shërbimeve:

- a) në gazetatat me qarkullim të gjerë në Zonën e Shërbimit ku do të aplikohen Tarifat e tilla të Shërbimit; dhe
- b) publikimet e tilla duhet të përsëriten së paku njëherë në javën pasuse të javës kur është bërë publikimi i parë.

25.3. Ofruesi i Shërbimeve do të jetë vet përgjegjës për publikimin dhe informimin publik të Tarifave të Shërbimit.

PJESA VI: ZBATIMI, GJOBAT DHE ANKESAT

Kapitulli 10: Zbatimi i Kushteve të Tarifave të Shërbimit

Neni 26: Zbatimi i Kushteve të Tarifave të Shërbimit

Rregullatori do të monitorojë përputhshmërinë me Kushtet e Tarifave të Shërbimit të përcaktuara në këtë Rregull në bazë të:

- a) raporteve të dërguara nga Ofruesit e Shërbimeve, në pajtim me formatin e përcaktuar nga Rregullatori;
- b) Inspektimeve dhe shqyrtimeve dhe nga raportet e dërguara nga entitetet tjera dhe autoritetet publike.

Kapitulli 11: Regjistrat dhe Raportet mbi Kushtet e Tarifave të Shërbimeve

Neni 27: Vend-ndodhja dhe Disponueshmëria e Regjistrave

Të gjithë regjistrat duhet të mbahen në zyrën kryesore të Ofruesit të Shërbimeve në mjedisin e sigurt dhe të besueshëm dhe duhet të jenë në dispozicion gjatë orëve të rregullta të punës për shqyrtim nga Rregullatori.

Neni 28: Raportet

28.1. Secili Ofrues i Shërbimeve duhet të përgatis dhe dorëzojë Rregullatorit raportet në formën e përcaktuar dhe brenda intervaleve të përcaktuara nga Rregullatori, kohë pas kohe.

28.2. Secili Ofrues i Shërbimeve duhet ti dorëzojë Rregullatorit, jo më vonë se 31 Mars të vitit kalendarik pas përfundimit të vitit të mëparshëm kalendarik, Raportin Vjetor në formatin të cilin e Rregullatori mund ta përcaktojë kohë pas kohe.

28.3. Secili Ofrues i Shërbimeve do të dorëzojë te Rregullatori Llogaritë kuartale të pa-audituar deri më 15 të muajit pasues pas muajve Mars, Qershor, Shtator, dhe Dhjetor në formatin i cili është kompatibil me standardet e kontabilitetit të pranuar përgjithësisht dhe në Kosovë dhe me udhëzimet e kontabilitetit rregullatorë të aprovuara nga Rregullatori.

Neni 29: Periudha e Mbajtjes së Regjistrave dhe Raporteve

Të gjithë regjistrat dhe raportet e parapara në Nenin 28 duhet të organizohen dhe mbahen nga Ofruesi i Shërbimeve për së paku pesë (5) vite kalendarike nga data kur janë përgatitur së pari ose kanë qenë të zbatueshme, përveç nëse ndonjë ligj tjetër i zbatueshëm përcakton se ato duhet të ruhen për një periudhë më të gjatë në cilin rast kjo e fundit do të aplikohet.

Kapitulli 12: Kundërvajtjet dhe Gjobat

Neni 30: Kundërvajtjet dhe Gjobat

30.1. Dështimi për të qenë në përputhje me cilatdo dispozita të Tarifave të Shërbimit të kësaj Rregulle dhe çfarëdo ngarkimi i Konsumatorëve me shumë që nuk është në pajtim me Tarifat e Shërbimit të aprovuara nga Rregullatori do të përbëjë kundërvajtje e cila shkakton që Ofruesi i Shërbimeve që është në faj t'i nënshtrohet dënimeve ose gjobave të vëna sipas Ligjin Nr. 03/L-086 mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetësimit dhe Kanalizimit të datës 15 qershor 2008.

30.2. Gjobat për shkeljen e Kushteve të Tarifave të Shërbimit do të llogariten dhe të vihen në pajtim me procedurat e krijuara sipas Rregullave mbi vënien e gjobave dhe me cilatdo Rregulla procedurale të përcaktuara nga Rregullatori kohë pas kohe.

Kapitulli 13: Ankesat

Neni 31: Ankesat

31.1. Ofruesit e Shërbimeve mund të parashtrojnë ankesën tek Komisioni Shqyrtues, të themeluar në pajtim me Ligjin nr. L/03-086 Mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetës dhe Kanalizimit të datës 15 qershor 2008:

- a) lëshimin, kufizimin, modifikimin, ndryshimin, plotësimin, përtëritjen ose zgjerimin e Tarifave të Shërbimit;
- b) revokimin, deklarimin e ndërprerjes ose anulimin e cilësdo Tarifë të Shërbimit të përcaktuar nga Rregullatori sipas kësaj Rregulle;
- c) përcaktimin ose zbatimin të cilitdo prej Kushteve të Tarifave të Shërbimit të parapara me këtë Rregull;
- d) vënien e çfarëdo gjobe për çfarëdo shkelje të Kushteve të Tarifave të Shërbimit ose për shkeljen e cilat do dispozitave të kësaj Rregulle.

31.2. Ofruesit e Shërbimeve mund të ankohen në gjyqet e Kosovës për çfarëdo vendimi të marrë nga Komisioni Shqyrtues mbi cilat do vendime konkrete sipas zbatueshmërisë së kësaj Rregulle në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-086 mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetës dhe Kanalizimit të datës 15 qershor 2008 të referuar në nenin 35.

31.3. Me marrjen e çfarëdo vendimi konkret mbi zbatueshmërinë e kësaj Rregulle, Rregullatori duhet të informojë Ofruesin e Shërbimeve të cilit iu është adresuar vendimi i tillë i zbatueshmërisë, mbi të drejtat e tij për tu ankuar në pajtim me këtë Nen.

PJESA VII: TË NDRYSHME

Neni 32: Gjuha Zyrtare e Rregullës



32.1. Kjo Rregull nxjerrët dhe publikohet në tri (3) versione me shkrim në gjuhët që përdoren në Kosovë:

- a) Gjuhën shqipe;
- b) Gjuhën serbe, dhe
- c) Gjuhën angleze.

32.2. Në rast të mospërputhjeve në cilindo nga këto versione të lëshuara të Rregullës, versioni në gjuhën shqipe do të mbizotërojë.

Neni 33: Hyrja në Fuqi

Kjo Rregull do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit.



.....
Raif Preteni

Drejtör

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim